



**KUVENDI I SHQIPËRISË
KOMISIONI PËR POLITIKËN E JASHTME**

Dokument parlamentar

RAPORT

PËR

**PROJEKTLIGJIN “PËR BUXHETIN E VITIT 2021”
(Shqyrtimi në parim)**

● **HYRJE**

Komisioni për Politikën e Jashtme, bazuar në nenet 32 - 38 dhe nenin 80 të Rregullores së Kuvendit, në cilësinë e Komisionit për dhënie mendimi, shqyrtoi në parim projektligjin “Për buxhetin e vitit 2021”, në mbledhjet e tij të datës 30 tetor dhe 2 nëntor 2020.

Relator për këtë projektligj ishte deputeti Z. Ervin Bushati.

Në mbledhjet e komisionit për shqyrtimin e projektligjit në parim ishin të pranishëm Ministri në detyrë për Evropën dhe Punët e Jashtme, Z. Gent Cakaj, përfaqësues të Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ministri i Shtetit për Diasporën, Z. Pandeli Majko dhe përfaqësues të kabinetit të ministrit, si dhe përfaqësues nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

I. BAZA KUSHTETUESE E PROJEKTLIGJIT

Projektligji “Për buxhetin e vitit 2021” është nismë e Këshillit të Ministrave, mbështetur në nenet 78, 83 pika 1 dhe 100, të Kushtetutës dhe në nenin 30 të ligjit nr.9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”.

Për sa i takon aspektit procedural, duke qenë se Komisioni për Politikën e Jashtme nuk është komision përgjegjës, ky komision e shqyrton këtë projektligj sipas fushave të tij të përgjegjësisë. Në seancat e zhvilluara komisioni shqyrtoi në parim projekt buxhetin e parashikuar për Ministrinë e Shtetit për Diasporën dhe për Ministrinë e Evropës dhe Punëve të Jashtme.

II. QËLLIMI DHE PËRMBAJTJA E PROJEKTLIGJIT

Projektbuxheti ka në themel objektivat e kuadrit makroekonomik e fiskal afatmesëm për tri vitet në vijim për ruajtjen dhe konsolidimin e mëtejshëm të stabilitetit makroekonomik të vendit si dhe krijimin e

klimes për një rritje të lartë e të qëndrueshme ekonomike. Projektbuxheti mban në konsideratë vlerësimet dhe rekomandimet e institucioneve financiare ndërkombëtare, si Komisioni Europian, FMN e Banka Botërore, si dhe të agjencive ndërkombëtare që mbikqyrin ekonominë e vendit tonë. Politikat dhe treguesit e tij, si çdo vit, janë konsultuar me Fondin Monetar Ndërkombëtar. Institucionet financiare ndërkombëtare kanë vlerësuar se ekonomia shqiptare po zhvillohet pozitivisht dhe me ritme të qëndrueshme, duke arritur një normë më të lartë rritjeje se mesatarja e Ballkanit Perëndimor.

- **PROJEKT-BUXHETI PËR MINISTRINË PËR EVROPËN DHE PUNËT E JASHTME**

Komisioni shqyrtoi projektbuxhetin e Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme në mbledhjen e datës 30 tetor 2020. Projektbuxheti i kësaj ministrie u prezantua në parim nga Ministri në detyrë për Evropën dhe Punët e Jashtme, Z.Cakaj. Të pranishëm ishin edhe përfaqësues të tjerë të kësaj ministrie si dhe përfaqësues nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

Gjatë prezantimit Z. Cakaj rikujtoi për Komisionin objektivat kryesore të MEPJ për vitin 2021, të cilat janë:

- Hapja e negociatave për anëtarësim në Bashkimin Evropian;
- Zhvillim i mëtejshëm i tërësisë së marrëdhënieve me vendet e tjera, me prioritet marrëdhëniet me partnerët strategjike, vendet mike dhe aleate si dhe vendet fqinjë;
- Vazhdimi i angazhimit për njohjen e mëtejshme ndërkombëtare të shtetit të Kosovës, për pjesëmarrjen dhe anëtarësimin i saj në organizatat rajonale dhe ndërkombëtare;
- Funkcionalizimi dhe mbështetja e punës së dy nismave rajonale me seli në Tiranë: Zyra Rajonale për Bashkëpunimin Rinor dhe Fondi i Ballkanit Perëndimor si dhe në tërësi sigurimi i pjesëmarrjes aktive në bashkëpunimin shumëpalësh rajonal, përfshirë RCC;
- Kryesimi i disa nismave rajonale dhe organizatave ndërkombëtare;
- Pjesëmarrje aktive dhe realizimi i kontributit të RSH në kuadër të NATO-s;
- Zbatimi i detyrimeve të anëtarësimit në organizata dhe forume shumëpalëshe, ku jemi palë;
- Plotësim i bazës ligjore të bashkëpunimit me vende të tjera;
- Forcimi dhe rritja e rolit të diplomacisë publike, ekonomike dhe diasporës, në shërbim të interesave ekonomike të Shqipërisë, promovimit dhe potencialeve për investime, tregti dhe bashkëpunimit ekonomik, tregtar dhe kulturor me partnerët tanë ndërkombëtarë dy dhe shumëpalësh;
- Realizim i një shërbimi konsullor të mbështetur në profesionalizëm, efikasitet, transparencë dhe përgjegjshmëri;
- Zhvillimi i kapaciteteve profesionale të stafit të MEPJ dhe përfaqësive për procesin e negociatave.

Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme do të operojë me 4 Programe Buxhetore:

- 1- Planifikimi, menaxhimi dhe Administrimi
- 2- Mbështetje Diplomatike Jashtë Shtetit
- 3- Aktiviteti Diplomatik dhe Konsullor i MEPJ
- 4- Mbështetja Institucionale për Procesin e Integritimit

Ministri në detyrë sqaroi se totali i buxhetit vjetor për MEPJ sipas projektbuxhetit është parashikuar **2,675,656,000** (Dy miliardë e gjashtëqind e shtatëdhjetë e pesë milionë e gjashtëqind e pesëdhjetë e gjashtë mijë lekë).

- **PROJEKT-BUXHETI PËR MINISTRINË E SHTETIT PËR DIASPORËN**

Komisioni shqyrtoi në parim projektbuxhetin e Ministrisë së Shtetit për Diasporën në mbledhjen e datës 2 nëntor 2020. Projektbuxheti i kësaj ministrie u prezantua nga Ministri i Shtetit për Diasporën Z. Pandeli Majko, i cili sqaroi se në parashikimin e buxhetit 2021 shpenzimet e parashikuara për këto institucione janë përfshirë në një program të vetëm financiar “Shërbime për Diasporën”, në të cilin janë parashikuar 221,600,000.00 lekë.

Relatori për Komisionin Z. Bushati sqaroi se misioni i Ministrisë së Shtetit për Diasporën është të përfaqësojë dhe të nxisë politikën e bashkëpunimit dhe të ndërveprimit me të gjithë shqiptarët, duke nxitur e fuqizuar bashkëpunimin në të gjitha fushat me shqiptarët jashtë kufijve të Republikës së Shqipërisë dhe shtetet ku ata banojnë.

Shpenzimet e parashikuara në projekt-buxhetin e vitit 2021 do t'u shpërndahen institucioneve që mbështesin misionin e Ministrisë së Shtetit për Diasporën duke ndihmuar dhe kontribuar konkretisht në çështje që lidhen me Diasporën, siç janë: Agjencia Kombëtare e Diasporës, Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës, Qendra e Botimeve për Diasporën dhe Qendra e Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët.

▣ **PËRFUNDIME**

Në aspektin **ligjor**, projektligji është në përputhje me nenet 78, 83, pika 1, dhe 158 të Kushtetutës.

Në aspektin **procedural**, projektligji është paraqitur në përputhje me Rregulloren e Kuvendit.

Në aspektin **formal**, projektligji përbëhet nga 3 krerë dhe 22 nene.

Në përfundim, deputetët e komisionit, pasi u njohën me projektbuxhetin e vitit 2021 për secilën nga ministrinë e mësipërme, në përfundim të diskutimeve, **miratuan në parim me shumicë votash projektligjin “Për buxhetin e vitit 2021”.**

RELATOR

ERVIN BUSHATI

KRYETARE

MIMI KODHELI



**KUVENDI I SHQIPËRISË
KOMISIONI PËR POLITIKËN E JASHTME**

Dokument parlamentar

Tiranë më 6 nëntor 2020

**RAPORT
PËR
PROJEKTLIGJIN “PËR BUXHETIN E VITIT 2021”
(Shqyrtimi nen për nen)**

➤ HYRJE

Komisioni për Politikën e Jashtme, bazuar në nenet 32 - 38 dhe nenin 80 të Rregullores së Kuvendit, në cilësinë e Komisionit për dhënie mendimi, shqyrtoi nen për nen projektligjin “Për buxhetin e vitit 2021”, në mbledhjet e tij të datës 4 dhe 6 nëntor 2020.

Relator për këtë projektligj ishte deputeti Z. Ervin Bushati.

Në mbledhjet e komisionit për shqyrtimin e projektligjit në parim ishin të pranishëm Z. Armand Skapi, Sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, Znj. Ilda Dega, drejtore për buxhetin dhe financat pranë Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ministri i Shtetit për Diasporën, Z. Pandeli Majko dhe përfaqësues të kabinetit të ministrit, si dhe përfaqësues nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

III. BAZA KUSHTETUESE E PROJEKTLIGJIT

Projektligji “Për buxhetin e vitit 2021” është nismë e Këshillit të Ministrave, mbështetur në nenet 78, 83 pika 1 dhe 100, të Kushtetutës dhe në nenin 30 të ligjit nr.9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”.

Për sa i takon aspektit procedural, duke qenë se Komisioni për Politikën e Jashtme nuk është komision përgjegjës, ky komision e shqyrton këtë projektligj sipas fushave të tij të përgjegjësisë. Në seancat e zhvilluara komisioni shqyrtoi nen për nen projekt buxhetin e parashikuar për Ministrinë e Evropës dhe Punëve të Jashtme dhe për Ministrin e Shtetit për Diasporën.

IV. PROJEKT-BUXHETI PËR MINISTRINË PËR EVROPËN DHE PUNËT E JASHTME

Komisioni shqyrtoi nen për nen projektbuxhetin e Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme në mbledhjen e datës 6 nëntor 2020.

Projektbuxheti i kësaj ministrie u prezantua nen për nen nga Sekretari i Përgjithshëm Z.Armand Skapi. Të pranishëm ishin edhe përfaqësues të tjerë të kësaj ministrie si dhe përfaqësues nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

Projektbuxheti i MEPJ për vitin 2021 është pjesë e hartimit të Programit Buxhetor Afatmesëm 2021-2023. Hartimi i projektbuxhetit të MEPJ është përgatitur në funksion të aktivitetit diplomatik dhe konsullor të MEPJ, përfshirë këtu edhe misionet diplomatike dhe postet konsullore jashtë vendit. Planifikimi ka në themel objektivat e përcaktuara të Programit të Qeverisë, Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim si dhe Planin Kombëtar të veprimit për zbatimin e rekomandimeve të Bashkimit Evropian.

Për vitin 2021 projektbuxheti i MEPJ mundëson vazhdimin normal të përfaqësimit të Shqipërisë në shtetet ku jemi akredituar, si dhe zbatimin e strategjive, politikave, objektivave të shërbimit të jashtëm.

Gjatë prezantimit Z. Skapi rikujtoi për Komisionin objektivat kryesore të MEPJ për vitin 2021, të cilat janë:

- Hapja e negociatave për anëtarësim në Bashkimin Evropian;
- Zhvillim i mëtejshëm i tërësisë së marrëdhënieve me vendet e tjera, me prioritet marrëdhëniet me partnerët strategjike, vendet mike dhe aleate si dhe vendet fqinjë;
- Vazhdimi i angazhimit për njohjen e mëtejshme ndërkombëtare të shtetit të Kosovës, për pjesëmarrjen dhe anëtarësimin i saj në organizatat rajonale dhe ndërkombëtare;
- Funkcionalizimi dhe mbështetja e punës së dy nismave rajonale me seli në Tiranë: Zyra Rajonale për Bashkëpunimin Rinor dhe Fondi i Ballkanit Perëndimor si dhe në tërësi sigurimi i pjesëmarrjes aktive në bashkëpunimin shumëpalësh rajonal, përfshirë RCC;
- Kryesimi i disa nismave rajonale dhe organizatave ndërkombëtare;
- Pjesëmarrje aktive dhe realizimi i kontributit të RSH në kuadër të NATO-s;
- Zbatimi i detyrimeve të anëtarësimit në organizata dhe forume shumëpalëshe, ku jemi palë;
- Plotësim i bazës ligjore të bashkëpunimit me vende të tjera;

Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme do të operojë me 4 Programe Buxhetore:

- 5- Planifikimi, menaxhimi dhe Administrimi
- 6- Mbështetje Diplomatike Jashtë Shtetit
- 7- Aktiviteti Diplomatik dhe Konsullor i MEPJ
- 8- Mbështetja Institucionale për Procesin e Integrit

Buxheti që është planifikuar të akordohet për vitin 2021, do t'i shërbejë Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme për realizimin e këtyre prioriteteve:

1. Zhvillimin e konferencës së parë ndërqeveritare për anëtarësimin e Shqipërisë në Bashkimin Evropian;
2. Garantimin e zbatimit të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit mes Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian;
3. Forcimin e kapaciteteve institucionale në funksion të procesit të negociatave të anëtarësimit dhe menaxhimit të asistencës financiare të Bashkimit Evropian;
4. Mirëmenaxhimit të asistencës dhe fondeve të BE-së në mbështetje të procesit të anëtarësimit.

Projekt-Buxheti i parashikuar paraqitet si në tabelat më poshtë:

Buxheti	Shpenzime korrente	Shpenzime kapitale
Projekt buxheti 2021	2,551,878,000	123,780,000

	(Dy miliardë e pesëqind e pesëdhjetë e një milion e tetëqind e shtatëdhjetë e tetë mijë lekë)	(njëqind e njëzetë e tre milionë e shtatëqind e tetëdhjetë mijë lekë)
Buxheti sipas PBA 2021	2,681,878,000 Dy miliardë e gjashtëqind e tetëdhjetë e një milionë e tetëqind e shtatëdhjetë e tetë mijë lekë)	123,780,000 njëqind e njëzetë e tre milionë e shtatëqind e tetëdhjetë mijë lekë)
Pakësuar me :	-130,000,000 (njëqind e tridhjetë milionë lekë)	0

Në shpenzimet kapitale përfshihen:

- ✓ **22,000,000** (njëzetë e dy milionë) leke projekte me financim të brendshëm
- ✓ **80,780,000** (tetëdhjetë milionë e shtatëqind e tetëdhjetë mijë) lekë projekte me financim të huaj
- ✓ **15,000,000** (pesëmbëdhjetë milionë) leke janë kosto lokale për projektet me financim të huaj
- ✓ **6,000,000** (gjashtë milionë) leke janë për TVSH për projektet e huaja

Z. Skapi sqaroi se krahasuar me buxhetin e vitit 2020, projektbuxheti për vitin 2021 rezultoi me pakësim të fondeve buxhetore në vlerë absolute 130,000,000 (njëqind e tridhjetë milionë) lekë, ose - 4.6%. Ai siguroi komisionin se ky pakësim nuk do të ndikojë mbarëvajtjen dhe cilësinë e aktiviteteve që ushtron Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme.

Sipas programeve buxhetore, krahasuar me kërkesat sipas PBA, projektbuxheti i vitit 2021 paraqitet në tabelën e mëposhtme:

<i>Programet buxhetore të MEPJ</i>	<i>Sipas PBA</i>	<i>Projektbuxheti</i>	<i>Pakësuar sipas programeve buxhetore</i>
01110 "Planifikim menaxhim Administrim"	149,600,000 (njëqind e dyzetë e nëntë milionë e gjashtëqind mijë lekë)	139,600,000 (njëqind e tridhjetë e nëntë milionë e gjashtëqind mijë lekë)	-10,000,000 (minus dhjetë milionë lekë)
01120 "Mbështetje diplomatike jashtë vendit"	2,238,776,000 (Dy miliardë e dyqind e tridhjetë e tetë milionë e shtatëqind e shtatëdhjetë e gjashtë mijë)	2,138,776,000 (Dy miliardë e njëqind e tridhjetë e tetë milionë e shtatëqind e shtatëdhjetë e gjashtë mijë lekë)	-100,000,000 (minus njëqind milionë lekë)
01130 "Aktiviteti diplomatik dhe konsullor I MEPJ"	210,500,000 (Dyqind e dhjetë milionë e pesëqind mijë lekë)	195,500,000 (Njëqind e nëntëdhjetë e pesë milionë e pesëqind mijë lekë)	-15,000,000 (Minus pesëmbëdhjetë milionë lekë)

01150 " Mbështetje institucionale pët procesin e integritit"	206,780,000 (Dyqind e gjashtë milionë e shtatëqind e tetëdhjetë mijë lekë)	201,780,000 (Dyqind e një milionë e shtatëqind e tetëdhjetë mijë lekë)	-5,000,000 (Minus pesë milionë lekë)
Totali i buxhetit vjetor:	2,805,656,000 Dy miliardë e tetëqind e pesë milionë e gjashtëqind e pesëdhjetë e gjashtë mijë lekë)	2,675,656,000 (Dy miliardë e gjashtëqind e shtatëdhjetë e pesë milionë e gjashtëqind e pesëdhjetë e gjashtë mijë lekë)	-130,000,000 (Minus njëqind e tridhjetë milionë lekë)

Pakësimi **130,000,000** (njëqind e tridhjetë milionë) lekë rezulton në shpenzimet korrente të institucionit, nga të cilat 110,000,000 (Njëqind e dhjetë milionë) lekë pakësim në shpenzimet operative dhe 20,000,000 (njëzetë milionë) lekë pakësim në pagat e personelit të përfaqësive diplomatike. Organika e MEPJ për vitin 2021 do të jetë me 577 punonjës gjithsej, nga të cilët 373 punonjës në përfaqësitë diplomatike dhe 204 punonjës në aparatit e MEPJ. Kjo shtesë do të mundësojë plotësimin e kapaciteteve njerëzore për përballimin me sukses të anëtarësimit në Këshillin e Sigurimit 2022-2023.

V. PROJEKT-BUXHETI PËR MINISTRINË E SHTETIT PËR DIASPORËN

Komisioni shqyrtoi nën për nën projektbuxhetin e Ministrit të Shtetit për Diasporën në mbledhjen e datës 4 nëntor 2020. Projektbuxheti i kësaj ministrie u prezantua nga Ministri i Shtetit për Diasporën Z. Pandeli Majko, i cili sqaroi se në parashikimin e buxhetit 2021 shpenzimet e parashikuara për këto institucione janë përfshirë në një program të vetëm financiar “Shërbime për Diasporën”, në të cilin janë parashikuar 221,600,000.00 lekë.

Shpenzimet e parashikuara në projekt-buxhetin e vitit 2021 do t’u shpërndahen institucioneve që mbështesin misionin e Ministrit të Shtetit për Diasporën duke ndihmuar dhe kontribuar konkretisht në çështje që lidhen me Diasporën, siç janë: Agjencia Kombëtare e Diasporës, Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës, Qendra e Botimeve për Diasporën dhe Qendra e Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët.

Buxheti i Alokuar për të katër institucionet paraqitet në tabelën më poshtë:

Nr.	Institucionet	Buxheti i parashikuar në projektligj Viti 2021
1.	Agjencia Kombëtare për Diasporën	87,600,000.00
2.	Fondi Shqiptarë për Zhvillimin e Diasporës	53,481,000.00
3.	Qendra e Botimeve për Diasporën	52,000,000.00
4.	Qendra e Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët	28,519,000.00

Gjithsej	221,600,000.00
----------	----------------

➤ Për Agjencinë Kombëtare të Diasporës

Agjencia Kombëtare e Diasporës, për realizimin e buxhetit mbështetet në nevojat më të domosdoshme institucionale dhe zbatimin korrekt të detyrimeve që rrjedhin nga ligji nr. 115, datë 18.12.2017 “Për Krijimin e Agjencisë Kombëtare të Diasporës”, Strategjisë Kombëtare të Diasporës 2018-2024 dhe Planit të Veprimit.

Buxheti i alokuar për vitin 2021 për këtë agjenci është në vlerën **87,600,000.00 lekë**, prej të cilave **79,600,000.00 lekë** janë shpenzime personeli dhe shpenzime korrente dhe **8,000,000.00 lekë** janë shpenzime kapitale.

Në zërin shpenzime korrente janë përfshirë pagat e punonjësve bazuar në strukturën e re të miratuar si dhe vlerat e kostuara të aktiviteteve dhe takimeve të cilat janë pjesë e programit vjetor të miratuar të Agjencisë Kombëtare të Diasporës.

Në zërin shpenzime kapitale bazuar në misionin e Agjencisë Kombëtare të Diasporës është përfshirë krijimi i bazës unike për regjistrimin e të dhënave të diasporës.

Gjithashtu theksojmë se në bazë të Vendimit nr. 686 datë 2.9.2020“Për kriteret e dhënies së bursave për shtetasit e huaj me origjinë shqiptare, për të studiuar në Republikën e Shqipërisë, nga Agjencia Kombëtare e Diasporës për vitin akademik 2020-2021”, Agjencia Kombëtare e Diasporës do të përballojë efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi. Kjo vlerë është paraqitur si pjesë e shpenzimeve korrente për vitin 2021.

Buxheti i detajuar paraqitet si më poshtë:

Tabela Nr.1

Zëri	2021
Shpenzime për paga(601,601)	17,600,000.00
Shpenzime korrente(602)	62,000,000.00
Shpenzime kapitale/Investime(231)	8,000,000.00
Totali	87,600,000.00

➤ Për Fondin Shqiptar për Zhvillim të Diasporës

Fondi Shqiptar për Zhvillim e Diasporës funksionon në bazë të VKM-ve përkatëse të Projekteve, konkretisht: Projekti "Diaspora përZhvillim" bazohet në VKM-në Nr.611, Dt.17.10.2018, Projekti “Diaspora Shkencore si një faktorë ndryshimi në procesin e Integritit European të Shqipërisë” bazohet në VKM-në Nr. 321, datë 15.05.2019, Projekti “Dhoma e Biznesit të Diasporës-Krijimi dhe Nxitja e Investimeve të Diasporës në Shqipëri” bazohet në VKM-në Nr.514, datë 19.07.2019.

Buxheti i alokuar për vitin 2021 është në vlerën 53.481,000.00 lekë shpenzime kapitale.

Zëri	2021
Shpenzime kapitale/Investime(231)	53.481,000.00
Totali	53.481,000.00

➤ **Për Qendrën e Botimeve për Diasporën**

Qendra e Botimeve për Diasporën është krijuar dhe funksionin sipas VKM-së Nr. 469 datë 26.07.2018 “Për Krijimin, Organizimin dhe Funksionimin e Qendrës së Botimeve për Diasporën”, duke synuar realizimin e objektivave themelore të saj, të cilat janë : Botimi, Sigurimi, Shpërndarja e teksteve Shkollore për nxënësit në Diasporë.

Buxheti i alokuar për vitin 2021 është në vlerën 36,000,000.00 lekë, prej të cilave 79,600,000.00 lekë janë shpenzime personeli si dhe shpenzime korrente dhe 16,000,000.00 lekë janë shpenzime kapitale.

Buxheti i detajuar jepet si në tabelë:

Zëri	2021
Shpenzime për paga(601,601)	15,600,000.00
Shpenzime korrente(602)	20,400,000.00
Shpenzime Kapitale/investime	16,000,000.00
Totali	52,000,000.00

➤ **Për Qendrën e Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët**

Qendra e Studimeve dhe e Publikimeve për Arbëreshët (QSPA) është institucioni kërkimor shkencor për diasporën shqiptare. Ajo kryen studime në fushën e historisë, letërsisë dhe të kulturës së komunitetit arbëresh dhe ushtron veprimtarinë e saj në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 601, Datë 04.09.2019. Buxheti i alokuar për vitin 2021 është si më poshtë është në vlerën prej 28,519,000.00 lekë.

Buxheti i detajuar jepet si në tabelë:

Zëri	2021
Shpenzime për paga(601,601)	17,600,000.00
Shpenzime korrente(602)	7.400,000.00
Shpenzime kapitale/Investime(231)	3.519,000.00
Totali	28,519,000.00

VI. PËRFUNDIME

Në aspektin **ligjor**, projektligji është në përputhje me nenet 78, 83, pika 1, dhe 158 të Kushtetutës.

Në aspektin **procedural**, projektligji është paraqitur në përputhje me Rregulloren e Kuvendit.

Në aspektin **formal**, projektligji përbëhet nga 3 krerë dhe 22 nene.

Në përfundim, nga studimi i projektligjit dhe relacionit shpjegues vërehet se:

Relacioni shoqërues i projektligjit shpjegon në mënyrë të detajuar treguesit kryesorë të buxhetit, të ardhurat dhe shpenzimet e planifikuara, financimet dhe realizimin e tyre.

Për projektbuxhetin e Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, Komisioni vlerësoi se projektbuxheti i plotëson nevojat në lidhje me detyrat e objektivat për vitin 2021.

Deputetët votuan nen për nen buxhetin për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe buxhetin për Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe me votat e shumicës së anëtarëve e miratuan atë.

Raporti i dërgohet Komisionit për Ekonominë dhe Financat si komision përgjegjës për shqyrtimin e projektligjit “ Për Buxhetin e vitit 2021”.

RELATOR

ERVIN BUSHATI

KRYETARE

MIMI KODHELI